

Ju njoftojmë se janë hapur aplikimet për të dërguar artikuj shkencorë për botim në Revistën Shkencore “Studime Juridike”, ISSN 2220-3990, botim i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Mirëpritën punime shkencore të personelit akademik, individëve profesionistë dhe punime origjinale të studiuesve nga institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Artikujt duhet të jenë rezultat i studimit, veprimtarisë profesionale apo kërkimore-shkencore të vetë autorit/autorëve dhe të mos jenë botuar më parë në ndonjë periodik apo publikim tjetër.

Afati i dorëzimit: 30 Prill 2023

Publikimi i artikullit: Qershor 2023

• **Udhëzime të përgjithshme për autorët:**

- Artikulli duhet të prezantojë një punë studimore, kërkimore-shkencore dhe të evidentojë elementë të qartë të origjinalitetit.
- Artikulli duhet të jetë jo më pak se 10 faqe dhe jo më shumë se 20 faqe kompjuterike, që konvertohen në po aq faqe reviste.
- Shkrimi i artikullit duhet të jetë “Times New Roman 12” me “Hapësirë1” dhe i gjithë teksti të jetë “Justified”.
- Artikulli duhet të respektojë elementët gramatikorë dhe gjuhësorë dhe të jetë i shkruar me “ë” dhe “ç”.

Çdo artikull duhet të dorëzohet i redaktuar dhe sipas kritereve të përcaktuara në dokumentin “Udhëzues për Autorët” publikuar në faqen e web-it të Fakultetit të Drejtësisë, www.fdut.edu.al, në dritaren dedikuar Botimeve.

Punimi i plotë duhet të dërgohet në formatin elektronik në adresën e e-mail-it revista.juridike@fdut.edu.al në formatin e kërkuar.